



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAM ORIENTUES PËR TESTIMIN E KANDIDATËVE TË LËNDËS “EDUKIM MUZIKOR/MUZIKË”

I. HYRJE

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së lëndës së edukimit muzikor është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e muzikës. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore të edukimit muzikor/muzikës.
- c) Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të edukimit muzikor/muzikës.

II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të lëndës së edukimit muzikor/muzikë është hartuar për të mbështetur dhe për të nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

edukimit muzikor në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese. Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe për zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor.
- Rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të muzikës është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së muzikës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** në funksion të tyre që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR-së në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), nr 343, datë 19.08.2013. - Udhëzimi nr. 16, datë 03.08.2016 “Për vitin shkollor 2016-2017 në sistemin arsimor parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21. datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore- edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. - Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. - Karta e performancës së shkollës. - Standardet e shkollës si qendër komunitare. - Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca në arsimin bazë”.

	- Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
FUSHA: PROGRAME LËNDORE	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të muzikës në shkollë”</p> <p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; - harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, në përputhje me kompetencat e programit; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të muzikës); - shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi; - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave; 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza kurrikulare, 2014. - Programet aktuale lëndore të edukimit muzikor (muzikë) për arsimin bazë, klasat I-IX. - Programet e reja të muzikës (2015, 2016) bazuar në kompetenca për klasat I,II,III,IV dhe VI,VII,VIII. -

<ul style="list-style-type: none"> - siguron informacion që demonstroi lidhjen e muzikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	
FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”	
Kompetenca I “Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e muzikës”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme: <i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; - identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); - planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta; - demonstroi qëndrim pozitiv ndaj arteve në përgjithësi dhe lëndës së muzikës; - edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së muzikës; - motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; - krijoi klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punoi me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.

<p style="text-align: center;">Kompetenca II</p> <p style="text-align: center;">“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e muzikës”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të të nxënësve; - përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; - planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësve; - përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve; - përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; - përdor proceset artistike në mësimdhënien-nxënien e muzikës; - demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësve; - shpjegon parimet e hartimit të një detyre përmbledhëse ose testi. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të nxënësve me situata, kompetenca dhe situata e të nxënësve, IZHA, 2014. - Korniza e vlerësimit të nxënësve, MAS, 23.07.2015. - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 - Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. - Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Portofoli i të nxënësve, IZHA, 2015. - Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese me në qendër nxënësve, si dhe metodologjinë e mësimdhënies së muzikës.
<p style="text-align: center;">Kompetenca III</p> <p style="text-align: center;">“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në muzikë”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - prezanton materiale muzikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Word; - nxiti nxënësve të bëjnë prezantime në muzikë duke përdorur programe kompjuterike të 	<ul style="list-style-type: none"> - Literaturë që ka në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënien –nxënies.

<p>njohura për ta;</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien; - përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së muzikës apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthurren me kërkime, gjetje dhe përdorime materiale nga website. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</p>	
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Draft standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA, 2016.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së muzikës”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p><i>Mësuesi i muzikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të cilat operon lënda e muzikës në klasat I-IX dhe në klasat X-XII; - përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve muzikore në klasat I-IX dhe në klasat X-XII; - përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehjeve; - dallon ndërvarësinë e koncepteve muzikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera; - përdor situata të ndryshme në muzikë, për të zhvilluar natyrshëm konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave I-IX dhe të klasave X-XII; - mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të muzikës me artet tjera dhe në jetën e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> - Programe dhe tekste të lëndës së muzikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-XII në arsimin parauniversitar.